

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr, Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/607
Datë: 7-8-2014

Mbështetur në vendimin nr. 1/576 të Rektorit (u.d.) të Universitetit të Prishtinës të datës 4.8.2014, Komisioni qendror në nivel Universiteti për rishqyrtim të ankesave të kandidatëve që kanë aplikuar për pranim në Fakultetin e Mjekësisë (këtu e tutje "Komisioni qendror i Universitetit" ose "Komisioni");

Duke rikujtuar mandatin e Komisionit qendror në nivel të Universitetit për të rishqyrtuar ankesat e paraqitura brenda afatit të konkursit nga kandidatët që kanë aplikuar për pranim në Fakultetin e Mjekësisë, me një detyrë të veçantë për rivlerësimin dhe marrjen e një vendimi në lidhje me vlerën dhe efektet e lëshimeve eventuale teknike;

Komisioni qendror i Universitetit, në përbërje të plotë, dhe në praninë e dy vëzhguesve (Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë dhe Kryetarit të Parlamentit të Studentëve), duke qenë në pajtueshmëri të plotë, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Komisioni qendror ka rishqyrtuar ankesat e paraqitura brenda afatit të konkursit nga kandidatët që kanë aplikuar për pranim në Fakultetin e Mjekësisë. Në mënyrë të veçantë, Komisioni ka bërë rivlerësimin e pyetjeve të caktuara në testet pranuese për Fakultet të Mjekësisë, ndaj të cilave ka pasur dyshime ose janë ngritur pretendime për ekzistimin e lëshimeve eventuale teknike.
- II. Komisioni ka vendosur që qartësinë dhe/ose vërtetësinë e pyetjeve dhe përgjigjeve në pyetjet e caktuara ta bëjë duke u mbështetur në literaturën përkatëse të përdorur sipas plan-programit të shkollave të mesme.
- III. Në përcaktimet e veta, Komisioni i është referuar edhe analizës së pyetjeve nga provimi pranues në Fakultetin e Mjekësisë, të bërë nga një komision tre-anëtarësh të Departamentit të Kimisë (Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës). Vlerësimet e ofruara nga ky komision janë shqyrtuar në kontekst të formulimit të pyetjeve dhe përgjigjeve përkatëse dhe krahasuar me përmbajtjen relevante në tekstet mësimore të shkollës së mesme.

IV. Komisioni qendror vlerëson punën e Komisionit të ankesave, të themeluar nga Fakulteti i Mjekësisë. Komisioni qendror vëren se, si rezultat i shqyrtimit të ankesave nga ana e komisionit të themeluar në Fakultetin e Mjekësisë, janë korrigjuar lëshime të caktuara, që në thelb kanë pas të bëjnë me mosleximin nga lexuesi optik i pyetjeve të caktuara si pasojë e plotësimit jo të qartë dhe të duhur të alternativave nga ana e kandidatëve (përkundërt udhëzimeve për ta bërë këtë gjë). Komisioni qendror është njoftuar se, Komisioni i ankesave pranë Fakultetit të Mjekësisë ka bërë leximin dhe rileximin manual të secilit test që është kërkuar të bëhet në mbyllje të fazës së ankesave pranë Fakultetit. Prandaj, Komisioni qendror ka vendosur se nuk është e nevojshme që të bëjë një lexim tjetër manual.

V. Komisioni qendror, gjithashtu, vëren se dallimet eventuale në përcaktimet që ka bërë ky komision në krahasim me përcaktimet e bëra nga komisioni i ankesave në Fakultetin e Mjekësisë kanë të bëjnë me qasjen e ndjekur ndaj vlerësimit të lëshimeve të caktuara teknike. Në këtë kuptim, nuk ka një kundërshti të patjetërsueshme në vlerësim. Në të vërtetë, ajo çfarë është e pranishme këtu ka të bëjë me faktin që, komisioni i ankesave pranë Fakultetit ka miratuar një qasje më të ngushtë dhe strikte profesionale, duke u mbështetur në përgjithësi në vlerësimin e komisionit tre-anëtarësh të Departamentit të Kimisë, i cili ndonëse vëren praninë e lëshimeve teknike në pyetje të caktuara, megjithatë konstaton se, ato nuk prekin thelbin e përgjigjes së saktë dhe se këto shqetësime i kualifikon si të pabaza. Në këtë kontekst, Komisioni ka përshtatur një metodë përcaktimi të dallueshme, dhe që ndjek një shkallë të lartë të bindjes për saktësinë dhe/ose vërtetësinë e pyetjes ose të alternativave të përgjigjes. Me fjalë të tjera, Komisioni ka vendosur që, kurdo që ka pasur lëshime të vërejtshme (të papërtshme më përmbajtjen relevante në tekste shkollore) ose, edhe më pak se kaq, kurdo që ka pasur dilema nëse Komisioni apo institucioni ka të drejtë në relacion me kandidatin, ka vendosur që, për të qenë tërësisht i sigurtë se nuk i bëhet e padrejtë asnjë prej kandidatëve, të vendosë në të mirë të kandidatëve, në mënyrën siç është sqaruar në secilën prej pyetjeve të trajtuara në vijim:

1. **Komisioni ka shqyrtuar pyetjen e kontestuar nr. 3 të testit A.** Komisioni rikujton analizën e Komisionit tre-anëtarësh të Departamentit të Kimisë, që lexon: “Meqë në opinion janë paraqitur dilema tek përgjigja e saktë në testin A, pyetja Nr. 3 nga lënda e Kimisë, konsiderojmë se përgjigja nën d) është e saktë në krahasim me përgjigjet nën a), b) ose c), opzione të cilat nuk janë aspak të përafërta me përgjigjen nën d). Vlen të theksohet se në opcionin nën d) është një lëshim i vogël teknik, i cili nuk e paragjykon mendimin rreth përgjigjes së saktë, konkretisht përgjigja do të duhet të ishte -2,-1,0,+1,+2 ndërsa është shkruar -2,-1,0,+1 gjë që nuk ka përputhshmëri me tri përgjigjet e gabuara (a, b, dhe c). Prandaj vlerësojmë se çdo kandidat që i është nënshtruar provimit pranues dhe ka dhënë si përgjigje përgjigjen nën d) është vlerësuar me të drejtë si e saktë.”

Pyetja nr. 3 e testit A, përfshirë alternativat, kanë qenë si në vijim:

Pyetja: Numri kuantik m paraqet orientim hapësinor të orbitaleve. Çfarë vlere ka ky numër nëse numri kuantik sekondar (I) ka vlerën 2?

Alternativat:

- 1, 0, +1
- 3,-2,-1,0,+1,+2,+3
- 4,-3,-2,-1,0,+1,+2,+3,+4
- 2,-1,0,+1 (vërejtje e Komisionit qendror: mungon +2; sipas çelësit: alternativa e saktë)

Në këtë rast, Komisioni qendror ka qenë i vëmendshëm ndaj analizës së Komisionit tre-anëtarësh të Departamentit të Kimisë. Komisioni qendror vëren që, tri prej alternativave që nuk janë vlerësuar si të sakta (alternativat nën a, b dhe c) nuk kanë të bëjnë fare me përgjigjen e saktë, dhe se alternativa nën d) do të duhej të ishte e saktë. Megjithatë, Komisioni vëren se, duke qenë që, si rezultat i lëshimit teknik (pra, mungesës +2 te alternativa nën d), Komisioni nuk është në gjendje të thotë se kjo alternativë është e plotë ose, me fjalë të tjera, e saktë, dhe si e tillë ka mundur të vë kandidatët në dilemë. Prandaj, vendosi që këtë pyetje ta konsideroj me gabim dhe, për pasojë, t'ua vlerësojë si përgjigje pozitive të gjithë atyre kandidatëve të cilëve përgjigja në këtë pyetje nuk u është vlerësuar si pozitive.

Në vijim të vendimit më sipër, Komisioni ka përcaktuar këtë metodë të vlerësimit të kësaj pyetjeje për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për pranim në Fakultetin e Mjekësisë:

- *E zbrazët:* pranohen 0,6 pikë (sa ka pasur një përgjigje e saktë);
- *E plotësuar gabimisht:* kthehen 0,2 pikë që janë marrë për përgjigje negative dhe shtohen 0,6 pikë për përgjigje të saktë = 0,8 pikë;
- *E saktë:* nuk shtohen pikë, pasi ato janë llogaritur.

2. **Komisioni ka shqyrtuar pyetjen e kontestuar nr. 14 të testit A.** Komisioni rikujton analizën e Komisionit tre-anëtarësh të Departamentit të Kimisë, që përmban: “Tek Testi A, pyetja nr. 14, konfiguracioni elektronik i gazeve fisnike paraqitet si $ns^2 np^6$ dhe duhet të merret i saktë sepse si i tillë paraqet konfiguracionin e vërtetë të shtresës së fundit elektronike të gazeve fisnike, gjë që është plotësisht në përputhshmëri me saktësinë e formulimit të vetë pyetjes dhe përgjigjes korresponduese në provim. Prandaj, konsiderojmë se përgjigja në pyetjen 14 është opcioni nën a. dhe kjo nuk paraqet kurrfarë dileme në saktësinë e përgjigjes. Ndërsa opsionet nën b), c), dhe d), nuk kanë asnjë element të saktësisë së përgjigjes.”

Pyetja nr. 14 e testit A, përfshirë alternativat, kanë qenë si në vijim:

Pyetja: Konfiguracioni elektronik i gazeve fisnike paraqitet si:

Alternativat:

- $ns^2 np^6$ (vërejtje e Komisionit qendror: përgjigja e saktë sipas çelësit)
- $ns^1 np^4$
- $ns^1 np^2$
- $ns^2 np^2$

Komisioni qendror, për të vendosur në lidhje me këtë pyetje, i është referuar librit Kimia (gjimnazi i shkencave natyrore) 11, që për autorë ka: Mustafë Bacaj, Selim Jusufi dhe Ramiz Hoti (Prishtinë, 2012). Në faqen 152 të këtij libri, thuhet: “Në grupin 18 të sistemit periodik bëjnë pjesë: heliumi (He), neoni (Ne), argoni (Ar), kriptoni (Kr), ksenoni (Xe) dhe radoni (Rn). Këto elemente janë joreaktive. Për këtë arsye, këto ndryshe quhen gaze fisnike. Heliumi përmban vetëm dy elektrone dhe ka konfiguracion elektronik $1s^2$, ndërsa elementet e tjera të këtij grupi kanë konfiguracion elektronik $ns^2 np^6$ ”.

Duke pas parasysh këtë më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se, ndonëse pjesa më e madhe e elementëve që përbëjnë konfiguracionin e gazeve fisnike paraqitet si $ns^2 np^6$, megjithatë njëri prej elementëve, siç është heliumi (He) ka konfiguracionin e vetë, të ndryshëm, elektronik ($1s^2$), pavarësisht që është element përbërës i konfiguracionit elektronik të gazeve fisnike. Prandaj, Komisioni ka gjetur se, në këtë pyetje, ka një pasaktësi në formulim, dhe se formulimi i duhur dhe i plotë do të ishte: “Konfiguracioni elektronik i gazeve fisnike, përveç heliumit, paraqitet si: ...” Si rezultat i kësaj pasaktësie, sado të vogël ose relative qoftë, dhe mundësisë që kjo të krijojë ose të ketë krijuar huti te kandidatët, Komisioni mori vendimin si më poshtë, duke vërejtur megjithatë që, pavarësisht atij mosaktësimi, pyetja përmban indikacion të rëndësishëm dhe përgjithësisht të qartë të përmbajtjes (pra, se fjala është për konfiguracionin e gazeve fisnike), dhe se alternativa e saktë është dhënë e plotë dhe e qartë në përgjigje.

Për pasojë, Komisioni ka përcaktuar këtë metodë të vlerësimit të kësaj pyetjeje për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për pranim në Fakultetin e Mjekësisë:

- *E zbrazët:* 0 pikë;
- *E plotësuar gabimisht:* kthehen 0,2 pikë që janë marrë për përgjigje negative;
- *E saktë:* nuk shtohen pikë, pasi ato janë llogaritur.

3. **Komisioni ka shqyrtuar pyetjen e kontestuar nr. 16 të testit A.** Komisioni rikujton analizën e Komisionit tre-anëtarësh të Departamentit të Kimisë, që lexon: “Në pyetjen nr. 16, tek Testi A, është bërë një lëshim teknik i cili nuk e prejudikon aspak dilemën rreth paraqitjes së izomerisë në mes të etanolit dhe dimetileterit ngase këto dy komponime ndërmjet veti janë izomere funksionale. Sa i përket lëshimit teknik në vend të “dimetileterit” është shkruar “dimetiletan” dhe kjo është vetëm një lëshim teknik i cili në baza shkencore nuk gjykon përgjigjen e saktë në pyetje. Prandaj, përgjigja e saktë pa asnjë dilemë është opcioni nën c).”

Pyetja nr. 16 e testit A, përfshirë alternativat, kanë qenë si në vijim:

Pyetja: Cili lloj i izomeris lajmërohet në mes etanolit dhe dimetiletanit

Alternativat:

- Izomeri e vargut
- Izomeri pozicionale
- Izomeri funksionale (vërejtje e Komisionit qendror: përgjigja e saktë sipas çelësit)
- Izomeri gjeometrike

Në rastin e pyetjes nr. 16 të Testit A, Komisioni e vlerëson analizën e Komisionit tre-anëtarësh dhe konstatimin se ky lëshim teknik në baza shkencore nuk gjykon përgjigjen e saktë në pyetje. Megjithatë, Komisioni qendror është i mendimit se, është një pritje shumë e lartë nga kandidatët që kanë aplikuar për regjistrim në Fakultetin e Mjekësisë që do të duhej të kenë ditur se fjala është për “dimetileter” dhe jo “dimetiletan” (ky i fundit, komponim i panjohur nga fusha e studimit). Komisioni qendror, gjithashtu, është vënë në dijeni se formulimi i testit në variantin me dorë ka përmbajtur nocionin “dimetileter”, porse duket që lëshimi ka ndodhur në momentin e shtypit në kompjutor. Sido që të ketë ndodhur, Komisioni qendror konsideron se ka dallim në formë dhe kuptim ndërmjet dy nocioneve, dhe duke qenë se fjala ka qenë për “dimetiletër”, ky nocion do të duhej të përmbahej në pyetje dhe jo nocioni “dimetiletan”. Si rezultat i këtij lëshimi teknik, Komisioni mori vendim që, në lidhje me këtë pyetje, t’ua vlerësojë si përgjigje pozitive të gjithë atyre kandidatëve të cilëve përgjigja në këtë pyetje nuk u është vlerësuar si pozitive.

Në vijim të vendimit më sipër, Komisioni ka përcaktuar këtë metodë të vlerësimit të kësaj pyetjeje për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për praninë në Fakultetin e Mjekësisë:

- *E zbrazët:* pranohen 0,6 pikë (sa ka pasur një përgjigje e saktë);
- *E plotësuar gabimisht:* kthehen 0,2 pikë që janë marrë për përgjigje negative dhe shtohen 0,6 pikë për përgjigje të saktë = 0,8 pikë;
- *E saktë:* nuk shtohen pikë, pasi ato janë llogaritur.

4. **Komisioni ka shqyrtuar pyetjen e kontestuar nr. 2 të testit B.** Komisioni rikujton analizën e Komisionit tre-anëtarësh të Departamentit të Kimisë, që lexon: “Tek testi B, në pyetjen nr. 2, në izotopet e oksigjenit ${}^8_{18}\text{O}$ kemi: në opsionet a), b) dhe c) janë dhënë tri formulime nga të cilat njëra është e saktë. E saktë është opsioni nën a), ndërsa për sqarim duhet theksuar se opsionet nën c. dhe d. të dyjat identike dhe të pasakta nuk shkaktajnë aspak ngatërresë për të arritur tek përgjigja e saktë në këtë pyetje. Prandaj, konsiderojmë se ky lëshim teknik nuk ka ndikuar fare në përgjigjen e saktë tek kandidatët, sepse mund të konkludojmë se kjo pyetje de facto i ka vetëm tri opsione për të zgjedhur, një opsion të saktë dhe dy të pa sakta.”

Pyetja nr. 2 e testit B, përfshirë alternativat, kanë qenë si në vijim:

Pyetja: Në izotopin e oksigjenit ${}^{18}_8\text{O}$ kemi:

Alternativat:

- 8 protone, 10 neutrone dhe 8 elektrone (vërejtje e Komisionit qendror: përgjigja e saktë sipas çelësit)
- 10 protone, 8 neutrone dhe 8 elektrone
- 8 protone, 8 neutrone dhe 10 elektrone
- 8 protone, 8 neutrone dhe 10 elektrone

Komisioni qendror pajtohet me vlerësimin dhe konstatimin e komisionit tre-anëtarësh të Departamentit të Kimisë, i cili konfirmohet edhe nga teksti shkollor Kimia 10, që për autorë ka: Muhamet Bicaj, Mustafë Bacaj, Selim Jusufi dhe Ramiz Hoti (Prishtinë, 2012), në faqen 60. Komisioni qendror vlerëson se pyetja e bërë është e formuluar qartë dhe saktë, sikundër është rasti edhe me përgjigjen e saktë (pra, alternativën e parë më sipër). Komisioni vëren se, dy alternativa kanë qenë të njëjta (alternativat 3 dhe 4). Sidoqoftë, duke qenë kështu, kjo vetëm sa e ka zvogëluar numrin e opsioneve të sakta (nga 4 në tre). **Në këtë rrethanë, Komisioni qendror vendos që këtë pyetje ta konsideroj si të saktë dhe pa gabime.**

5. **Komisioni ka shqyrtuar pyetjen e diskutuar nr. 1 të testit B.** Kjo pyetje nuk ka qenë subjekt shqyrtimi dhe analize nga komisioni tre-anëtarësh i Departamentit të Kimisë. Kjo është sjellë në dijëni të Komisionit nga ana e Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë.

Pyetja ka këtë përmbajtje: Në gjendjen e lëngët tek substancat:

Alternativat:

- Distanca midis grimcave është e vogël
- Forcat tërheqëse janë më të mëdha sesa tek substancat e ngurta
- Nuk kemi mundësinë që ato të komprimohen (vërejtje e Komisionit qendror: përgjigja e saktë sipas çelësit)
- Ato marrin formën e enës në të cilën gjenden (vërejtje e Komisionit qendror: përgjigja e saktë sipas çelësit).

Komisioni qendror vëren se, në rastin e kësaj pyetjeje, kanë qenë dy alternativa të sakta, alternativat 3 dhe 4. Pas hetimit të kësaj rrethane, Komisioni pranues i Fakultetit të Mjekësisë ka programuar çelësin e lexuesit optik asisoji që ka marrë si të saktë cilëndo prej këtyre alternativave (3 apo 4). Duke qenë që kjo pyetje është vlerësuar nga ana e Komisionit si pyetje logjike, e thjeshtë, dhe madje kandidatët kanë qenë të privilegjuar me një pyetje të tillë, dhe duke pas parasysh faktin që kjo situatë është adresuar në çelës, Komisioni i konsideron si të pabazuara dhe jovalide pretendimet për pyetje të gabuar ose, pretendimet se, ndonjëri prej kandidatëve mund të jetë hutuar për atë se cila është alternativa e saktë ndaj një rrethane kur pyetja është logjike (p.sh., në gjendjen e lëngët tek substancat, ato marrin formën e enës në të cilën gjenden, etj.), dhe se, ndonëse ka pas edhe një alternativë valide (që do të thotë se nuk kemi mundësinë që ato të komprimohen), kandidatët, në këtë kontekst, kanë pasur përparësinë e zgjedhjes midis dy alternativave të sakta nga katër sa ka pasur pyetja. Përkundrajt kësaj, Komisioni është vënë në dijëni të rrethanës kur kandidatë të caktuar kanë hezituuar të zgjedhin njërin prej alternativave si rezultat i faktit të pasjes së dy alternativave të saktë brenda të njëjtës pyetje derisa, në parim, do të duhej të ishte vetëm një alternativë e saktë. **Për pasojë, Komisioni qendror mori vendim që t'ua marrë si përgjigje të saktë të gjithë atyre që nuk kanë rrethuar asnjërën alternativë të kësaj pyetjeje, si shtesë e vlerësimit tashmë si të saktë të dy alternativave të kësaj pyetjeje (3 dhe 4).**

Në vijim të vendimit më sipër dhe arsyeve të thëna aty, Komisioni ka përcaktuar këtë metodë të vlerësimit të kësaj pyetjeje për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për pranim në Fakultetin e Mjekësisë:

- *E zbrazët:* pranohen 0,6 pikë (sa ka pasur një përgjigje e saktë);
- *E plotësuar gabimisht:* mbetet vlerësimi ekzistues;
- *E saktë:* nuk shtohen pikë, pasi ato janë llogaritur.

6. **Komisioni ka shqyrtuar pyetjen e diskutuar nr. 13 të testit A.** Kjo pyetje nuk ka qenë subjekt shqyrtimi dhe analize nga komisioni tre-anëtarësh i Departamentit të Kimisë. Kjo është sjellë në dijeni të Komisionit nga ana e kandidatëve që kanë paraqitur ankesë për rishqyrtim të testit.

Pyetja ka këtë përmbajtje: Gjatë procesit të pjekjes së gjipsit natyror ($\text{CaSO}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$) dhe formimit të gjipsit të pjekur, përmbajtja e ujit në këtë mineral do të:

Alternativat:

- Rritet
- Zvogëlohet (vërejtje e Komisionit qendror: përgjigja e saktë sipas çelësit)
- Mbetet e njëjtë
- Largohet komplet

Komisioni qendror, për të vendosur në lidhje me këtë pyetje, i është referuar librit Kimia (gjimnazi i shkencave natyrore) 11, që për autorë ka: Mustafë Bacaj, Selim Jusufi dhe Ramiz Hoti (Prishtinë, 2012). Në faqet 204 dhe 205 të këtij libri, autorët konfirmojnë alternativën e saktë të pyetjes më sipër. **Prandaj, Komisioni e vlerëson këtë pyetje dhe alternativën përkatëse si të saktë dhe pa gabime.**

7. **Komisioni ka shqyrtuar pyetjen e diskutuar nr. 13 të testit B.** Kjo pyetje nuk ka qenë subjekt shqyrtimi dhe analize nga komisioni tre-anëtarësh i Departamentit të Kimisë. Kjo është sjellë në dijeni të Komisionit nga ana e kandidatëve që kanë paraqitur ankesë për rishqyrtim të testit.

Pyetja ka këtë përmbajtje: Gëlqerja [$\text{Ca}(\text{OH})_2$] gjatë reaksionit të lidhjes në formimin e CaCO_3 do të absorbojë:

Alternativat:

- Vetëm molekulat e ujit
- Vetëm molekulat e dioksidës së karbonit
- Molekulat e dioksidës së karbonit dhe të ujit (vërejtje e Komisionit qendror: përgjigja e saktë sipas çelësit)
- Nuk absorbon asnjërën nga këto molekula

Komisioni qendror, për të vendosur në lidhje me këtë pyetje, i është referuar librit Kimia (gjimnazi i shkencave natyrore) 11, që për autorë ka: Mustafë Bacaj, Selim Jusufi dhe Ramiz Hoti (Prishtinë, 2012). Në faqen 204 të këtij libri, autorët konfirmojnë alternativën e saktë të pyetjes më sipër. **Prandaj, Komisioni e vlerëson këtë pyetje dhe alternativën përkatëse si të saktë dhe pa gabime.**

- VI. Vendimi i Komisionit qendror në nivel Universiteti i përcillet Senatit të Universitetit për miratim në mbledhjen e tij të radhës.
- VII. **Këshillë juridike:** Ndaj vendimit të këtij Komisioni, pasi të jetë miratuar në Senatin e Universitetit të Prishtinës, palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.


Shtojcat:

1. *Raporti i analizës së pyetjeve nga provimi pranues në Fakultetin e Mjekësisë;*
2. *Faqja nr. 60 e librit Kimia 10, të autorëve Muhamet Bicaj, Mustafë Bacaj, Selim Jusufi dhe Ramiz Hoti (Prishtinë, 2012);*
3. *Faqet nr. 152, 204 dhe 205 të librit Kimia (gjimnazi i shkencave natyrore) 11, të autorëve Mustafë Bacaj, Selim Jusufi dhe Ramiz Hoti (Prishtinë, 2012).*

Nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit:

Anëtarë të Komisionit qendror në nivel Universiteti për rishqyrtim të ankesave të kandidatëve që kanë aplikuar për pranim në Fakultetin e Mjekësisë:

Prof. Dr. Musli Bajraktari (Dekan, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike), kryesues



Prof. As. Dr. Qerim Qerimi (u.d. Prorektor për çështje të mësimit dhe studentëve)

Prof. Dr. Tahir Arbnesi (Dekan, Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore)

Avni Puka (Anëtar i Senatit të Universitetit)

Esat Kelmendi (Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit)

Nënshkrimet e vëzhguesve:

Prof. Dr. Salih Ahmeti (Dekan i Fakultetit të Mjekësisë)

Irfan Veseli (Kryetar i Parlamentit Studentor)
